



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË
KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK

Nr. 554 / Prot.
3

Patos, më 27/03 / 2024

PROCESVERBALI I TAKIMIT 25 MARS 2024

Vendi: ambientet e shkollës “Mustafa Matohiti”

Ora e fillimit : 14 :30

Ora e mbarimit : 15:50

Tema e Konsultimit: Vendosje të linjës së transportit publik “Patos i ri -Muatafa Matohiti - Margëlliç”

Baza Ligjore: Në zbatim të ligjit me nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 18 dhe 54 të ligjit nr. 146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Rregullores së Këshilli Bashkiak “Për konsultimin publik” si dhe kërkesës së banorëve për zonat: “Margëlliç”, “Rerës”, “Dukas Breg”, “Mustafa Matohiti”, me nr. 554 datë 26.02.2024.

Pjesëmarrës: Kryetar i Bashkisë z. Fation Buro Kryetar i Këshillit z. Armand Ahmetaj , anëtarë të Këshillit të Bashkisë Patos, mësues, banorë të zonave: “Margëlliç”, “Rerës”, “Dukas Breg”, “Mustafa Matohiti” dhe Rreth 89 pjesëmarës (kryetarë të fshatrave, mësues dhe banorë të zonës).

Takimin hapet nga Kryetari i Këshillit:

Kryetar i Këshillit z. Armand Ahmetaj: Në zbatim të ligjit me nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 18 dhe 54 të ligjit nr. 146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Rregullores së Këshilli

Bashkiak “Për konsultimin publik” si dhe kërkesës së banorëve për zonat: “Margëlliç”, “Rerës”, “Dukas Breg”, “Mustafa Matohiti” sot jemi në këtë dëd gjesë pubike për të parë mundësitë që do



Kryetar i Këshillit z. Armand Ahmetaj

Degjesë Publike me temë :

**“Vendosje të linjës së transportit publik
“Patos i ri -Muatafa Matohiti -
Margëlliç”**

Mars 2024

të oforoj bashkia. Fjala është për kryetarin e bashkisë

Kryetar i Bashkisë z. Fation Duro: Duke marrë indicie nga kërkesa tuaj me nr. 554 prot., datë 26.02.2024 ku keni shprehur shqetësimin tuaj për mungesën e shërbimit të transportit publik për linjën “Patos i ri -Muatafa Matohiti - Margëlliç” dhe të ndodhur përpara faktit që subjekti Erti 2007 ka dorëzuar licensën me pretendimin se nuk ka punë dhe se nuk mund të kryej këtë shërbim për shkak të humbjeve dhe duke qenë se nga kontaktet e marra personalisht edhe me subjektin Arjani për ofrimin e shërbimit të transportit publik për zonat tuaja nuk arritëm dot lidhjen e një marrveshje. Sot jemi këtu për t’i dhënë mundësisë mbi zgjidhjen që bashkia ka menduar për transportin publik të zonës suaj por së pari doja t’ju dëgjoja juve lidhur mbi problemet tuaja.



**Kryetar i Bashkisë
z. Fation Duro**

Degjesë Publike me temë :

**“Vendosje të linjës së transportit publik
“Patos i ri -Muatafa Matohiti -
Margëlliç”**

Mars 2024

Banor i zonës Mustafa Matohiti z. Dritan Rrapushaj - në radhë të parë ju falenderoj kryetar që i'u përgjigje këkesës sonë si banorë së dyti linja e transportit ka qenë qysh në kohën e munizmit dhe nuk e kuptojmë se përse kjo na bëhet si banorë pasi mungesa e transportit në zonë na izolon nga pjesa tjetër e qytetit. Sot ju problemin e dini dhe duhet të na jepni zgjidhje.



**Banor i zonës Mustafa Matohiti
z. Dritan Rrapushaj**

Degjesë Publike me temë :

**“Vendosje të linjës së transportit publik
“Patos i ri -Muatafa Matohiti - Margëlliç”**

Mars 2024

Banor i zonës Mustafa Matohiti z. Ndricim Paja - është turp i madh që në 2024 të mos ketë transport publik, mirë ata që kanë makina por ata që nuk kanë çfarë do të bëjnë? Doja të dija çfarë zgjidhje do të na jepni dhe kur do të ofrohet si shërbim. Gjithashtu dua të ngre një shqetësim lidhur mbi dëmtimin e rrugës më lagjjen Rrapushaj e cila është teje e dëmtuar dhe e pakalushme nga mjetet.



**Banor i zonës Mustafa Matohiti
z. Ndricim Paja**

Degjesë Publike me temë :

**“Vendosje të linjës së transportit publik
“Patos i ri -Muatafa Matohiti - Margëlliç”**

Mars 2024

Anëtar i këshillit të bashkisë z. Eduart Faslliaj – për shkak të situatës së papërshtatshme dhe në mungesë të fonisë me le të dëgjojmë njëri-tjetrin dhe duke ju falenderuar për pjesëmarrjen në këtë takim konsultativ me iniciativën e vet banorëve për vendosjen e linjës së transportit publik

“Patos i ri -Muatafa Matohiti – Margëlliç” dhe mesa kuptoj shqetësimi është i njëjtë për të gjithë ndaj le të dëgjojmë kryetarin e bashkisë se çfarë zgjidhje i është dhënë këtij problemi.



**Anëtar i këshillit të bashkisë
z. Eduart Faslliaj**

Degjese Publike me temë :
**“Vendosje të linjës së transportit publik
“Patos i ri -Muatafa Matohiti - Margëlliç”**

Mars 2024

Kryetar i Bashkisë z. Fation Duro: duke ju falenderuar për gjithcka që thatë si dhe çdo mendim apo shqetësim tuajin më lejoni t’ju bëj me dije se bashkia për gjithë këto muaj ka bërë përpjekje për zgjedhjen sa më shpejtë të transportit publik për patosin lart por çdo tentativë e jona për negociata nuk arriti në një finalitet ndaj në këto kushte ne kemi menduar që e vetmja zgjidhje është ofrimi i këtij shërbimi nga vet bashkia. Me pak fjalë bashkia do të gjejë mundësinë për vendosje të mjeteve dhe çmimi biletës nuk do të ndryshojë.



Kryetar i Bashkisë z. Fation Duro

Degjese Publike me temë :
**“Vendosje të linjës së transportit publik
“Patos i ri -Muatafa Matohiti -
Margëlliç”**

Mars 2024

Banore e zonës Mustafa Matohiti znj. Lule Isai- ju falenderoj që erdhët sot për të ndarë me ne shqetësimin tonë si banorë për mungesën e transportit publik. A nuk jemi edhe ne pjesë e komunitetit të patosit? Për tre muaj rresht përse nuk është dhënë një zgjidhje nga bashkia dhe kjo nuk është e drejtë. Në lagjen tonë nuk ka doktor dhe përse nuk organizohet një planifikim për shërbimin shëndetësor. Në lagjen tonë nuk është shtruar asnjë rrugë dhe përse ky diferencim për

ne. Edhe pse ka shumë probleme të tjera zona jonë kam bindjen se keni ardhur me një zgjidhje për ne pasi kemi tre muuj që vuajmë mungesën e këtij shërbimi dhe është e kotë që të flasim të gjithë pasi do të përsërisim njëri-tjetin, kërkojmë zgjidhje.



**Banore e zonës
znj. Lule Isai**

Degjesë Publike me temë :

**“Vendosje të linjës së transportit publik
“Patos i ri -Muatafa Matohiti -
Margëlliç”**

Mars 2024

Banore i zonës z. Hysen Ismaili – i nderuar kryetar i Bashkisë dhe i Këshillit problemi i shtruar nga ju është shumë i drejtë, ne kemi shumë probleme por më kryesori është mungesa e urbanistikës ne si banorë kërkojmë të na jepet zgjidhje sa më shpejtë pasi jeni pensionist dhe pagesat e taksive jo të licensuara janë tepër të larta ndaj na jepni sa më shpejtë zgjidhje dhe të na thuhet tani nga kryetari se kur do të filloj urbanistika pasi jemi pensionist për të mos folur për problemet e tjera në lidhje me shëndetësinë që nuk kemi mjek dhe detyrohemi të shkojmë në Patos pasi nuk ka shërbim dhe në zonën tonë nuk është kyer asnjë shërbim për 30 vjet dhe është turp që të mos shtrohet një rrugë prej 150 m. Edhe rruga Patos -Ofiçinë duhet të rregullohet pasi kemi vështirësi për të kontaktuar me qytetin Ballshit.



**Banor i zonës
znj. Hysen Ismaili**

Degjesë Publike me temë :

**“Vendosje të linjës së transportit publik
“Patos i ri -Muatafa Matohiti -
Margëlliç”**

Mars 2024

Anëtar i Këshillit të Bashkisë z. Eduart Faslliaj – jam plotësisht dakort me të gjitha shqetësimet e ngritura nga ana juaj lidhur edhe me mungesën e shërbimit të transportit publik, me mungesën e shërbimit të shëndetit publik, mungesën e infrastrukturës rrugore dhe e kemi pranuar që është faji jonë që nuk arritëm t’ja jepnim zgjidhje qysh në fillim problemit të mungesës së transportit jo vetëm për banorët e lagjes sonë dhe Margëllicit por për të gjithë përdoruesit e rrugës të cilët përshkojnë këtë segment rrugor siç janë edhe mësuesit të cilët po shoh që i kemi edhe pjesë të dëgjësës publike pasi edhe ata janë përdorues të rrugës.



**Anëtar i Këshillit të Bashkisë
z. Eduart Faslliaj**

Degjesë Publike me temë :

**“Vendosje të linjës së transportit publik
“Patos i ri -Muatafa Matohiti -
Margëllic”**

Mars 2024

Ne në cilësinë e anëtarit të këshillit të bashkisë e kemi diskutuar me kryetarin e bashkisë dhe ekzekutivin për zgjidhjen e problemit të transportit për linjën publike dhe duke qenë se ishte e pamundur zgjidhja me subjektet private për mbulimin e shërbimit kemi menduar që bashkia të vendosi mjete në dispozicion të cilat i ka apo do t’i blejë apo do t’i marrë me qira, një vendim që padiskutim do të marrim miratim të padiskutuar edhe në këshillin bashkiak me qëllim ofrimin e shërbimit të transportit publik dhe çmimi i vendosur paraprakisht do të jetë po i njëjti pra në masën 50 lekë. Tani fjala është për ju nëse do të keni ndojë propozim tjetër.



Banor i zonës Mustafa Matohiti Dritan Rrapushi - problemi i furgonave duhet të zgjidhet sa më shpejtë pasi është problem tepër i madh, na keni izoluar nga pjesa tjetër e qytetit.



**Banor i zonës Mustafa Matohiti
z.Dritan Rrapushi**

Degjesë Publike me temë
“Vendosje të linjës së transportit publik
“Patos i ri -Muatafa Matohiti -
Margëlliç”

Mars 2024

Banor i zonës Mustafa Matohiti Dritan Rrapushi Niko Xhaja – ne nuk kemi kundërshtime nëse ky shërbim ofrohet nga bashkia apo nga privati. E rëndësishme për ne është fakti i zgjidhjes së shërbimit të transportit publik. Edhe një shqetësim tjetër kryetar ejani të shikoni rrugën e lagjes pasi nuk hyjmë dot në banesë jo me makinë që jo e jo por as në këmbë.



**Banor i zonës Mustafa Matohiti
Noko Xhaja**

Degjesë Publike me temë
“Vendosje të linjës së transportit publik
“Patos i ri -Muatafa Matohiti -
Margëlliç”

Mars 2024

Kryetar i Bashkisë z. Fation Duro: patjetër që do të vij ta shoh se si është gjendja reale e rrugës dhe patjetër që do të shohim mundësinë për ndërhyrje. Lidhur mbi temën e takimit nëse ndokush tjetër ka ndonjë paqartësi, sygjërim apo merak pasi për ne është e rëndësishme që ky shërbim të ofrohet në kohë reale dhe me standarte shërbimi dhe ajo që u diskutua nga të gjithë është ofrimi i

shërbimit të transportit publik një shërbim që do të padiskutim ka marrë vëmendjen jo vetëm të ekzekutivit por edhe të këshillit. Edhe një herë unë dua t'ju falenderoj që u bëtë pjesë e kësaj dëgjese publike.

Konceptoi:
Koordinator i Konsultimit Publik
Suzana Hysenaj



Pranoi:
Sekretar i Këshillit
Refaela Xeba



Tema e Konsultimit: Vendorsje të linjës së transportit publik “Patos i ri -Muatafa Matohiti - Margëlliç”



